

## RELACION

### Mbi Ecurinë Financiare Buxhetore të AMSHC-se për 3-mujorin e dyte të vitit 2015

Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile, në mbështetje të ligjit nr. Nr. 160/2014,dt.27.11.2014 “Për buxhetin e shtetit për vitin 2015”, Udhezimit te Ministrit te Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimin te buxhetit” si dhe Udhezimit nr.2 datë 09.01.2015 “Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2015”, i është akorduar një fond i planifikuar prej 120 milione e 500 mijë lekë, i detajuar si më poshtë vijon:

Tabela 1 (ne Leke)

<b>Fondi i Pagave:</b>	<b>11,500,000 Lekë (zeri 600)</b>
<b>Fondi i Sigurimeve Shoqerore:</b>	<b>2,000,000 leke (zeri 601)</b>
<b>Fondi per Shpenzime Operative:</b>	<b>5,000,000 Lekë (zeri 602)</b>
<b>Fondi per transfertat ndaj te treteve:</b>	<b>101,000,000 Lekë (zeri 604)</b>
<b>Fondi per Investimet e Trupezuara:</b>	<b>1,000,000 Lekë (zeri 231)</b>
<b>TOTAL</b>	<b>120,500,000 LEKE</b>
<b>Fondi per Transfertat ndaj te treteve (604-6) (gjendje 2014)</b>	<b>700,000 Leke (zeri 604-6)</b>

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor, për periudhën e raportuar, AMSHC, ka realizuar vlerën buxhetore në **73,134,755 leke** nga totali prej **121,200,000 Leke** ( *te Fondi total do llogaritet fondi prej 120,500,000 lekesh sipas Buxhetit 2015 plus fondin prej 700,000 lekesh 601/6 mbartur nga viti 2014 si e ardhur jashte limitit*) pra eshte **realizuar rreth 60 % të fondit të planifikuar vjetor.**

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqerore** (zeri 600-601), është realizuar në zbatim te strukturës organizative të miratuar, me VKM Nr. 769, date 15.07.2009 dhe te VKM Nr. 11 Date 14.01.2015 “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2015, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”.

Gjatë 3- mujorit të dyte të vitit 2015, numri mesatar i punonjësve është realizuar 13 punonjës me kontratë të përhershme si dhe dy punonjës me kontratë të përkohshme.

Nga fondi i përgjithshëm i pagave dhe shpërblimeve, si dhe i sigurimeve shoqërore, për këtë periudhë, është realizuar respektivisht;

**5,016,238 Lekë** (zeri 600) për paga, realizimi **43.6 %**.

**407, 613 Lekë** (zeri 601) për kontribute për sigurimet shoqërore, realizimi **41.2 %**.

**Fondi për shpenzime në zerin Mallra dhe Shërbime** (zeri 602), për vitin 2015, është planifikuar në vlerën 5,000,000 leke.

Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **2,911,768 Lekë 58.2 % e planit vjetor**.

Gjithashtu, në realizimin e shpenzimeve operative, AMSHC është mbështetur në një shpërndarje sa më racionale të kërkesave, të cilat lidhen me;

- Realizimin e shpenzimeve, të detyrueshme ndaj shtetit, si detyrime taksa e tatime, energji elektrike, uje, shërbime postare e telefonike falas për publikun, në funksion të një veprimtarie normale institucionale.

- Kyerjen e të gjitha blerjeve për nevojat e AMSHC, publikime, blerje kancelarike, riparime automjeti, etj.

- Kryerjen e pagesave për likuidimin e detyrimeve furnitore dhe të tregu, të mbartura nga 2014.

- Krijimin e facilitetit për udhëtime pune jashtë vendit dhe brenda vendit me fokus rritjen e kapaciteteve të stafit si dhe shkëmbimin e eksperiencave dhe praktikave më të mira me vendet e rajonit dhe më gjërë.

**Fondi në zerin për Transferime Korrente të Brendshme** (zeri 604), për vitin 2015 është planifikuar në vlerën 101,000,000 leke.

Ky është dhe zeri me me peshe në strukturën e buxhetit të AMSHC, duke qenë se dhe vetë misioni i këtij institucioni ka si qëllim kryesor financimin e Shoqërisë Civile me Grante për projektpropozimet të OJF përfituese si dhe mbështetjen teknike të OSHC ve në vend.

Edhe për këtë zë, për periudhën respektive është realizuar vlera prej **63,856,752 Lekë ose 62.7 % e planit vjetor**.

Në realizimin e këtij zeri, AMSHC ka vazhduar me disbursimet e mbetura të Thirrjes 5 dhe Thirrjes 6 ndërkohë që tashme janë disbursuar kasti i parë prej 70% e granteve të kontraktuara të thirrjes nr.7 si dhe në muajt në vijim do të vijojë lidhja e kontratave si dhe disbursimi i kontratave që do lidhen për Thirrjen Nr.8.

**Fondi per shpenzim investime** (zeri 231) ,

**1,000,000 Lekë** (zeri 231) për Investime te Trupezuara, realizimi ka qënë 25,500 leke pra 2.5 % si dhe nderkohe Komisioni i Prokurimeve me Vlera te Vogla ne Agjencine per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile ka vijuar me procedurat e prokurimit per Investime sipas parashikimit.

AMSHC, ka zbatuar me korrektesi te gjitha detyrimet qe rrjedhin nga Ligji Nr. 10093 Date 09.03.2009 "Per Organizimin dhe Funksonimin e Agjencise per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile", si dhe legjislacionin admnistrativo-financiar shqiptar.

**Drejtor Ekzekutiv**

**ANDI KANANAJ**

**RAPORT I MONITORIMIT FINANCIAR (tre -mujori I dyte 2015)**

Formati nr.6: Raporti i Shpenzimeve Faktike te Programit sipas Artikujve.

Periudha Janar - Qershor 2015

Ne Leke

Grupi						88
Emri i Grupit	AGJENCIA PER MBESHTETJEN E SHOQERISE CIVILE				Kodi	1110
Programi	Mbeshtetje per Shoqerine Civile				Titulli	
		Shpenzimet e AMSHC				
Programet		PBA	Buxhet 2015	Fakti	Diferenca	
Titulli	Emri	Plan 2015	Plani I rishikuar gjate vitit	2015	2015	
600	Paga	11,500,000	11,500,000.0	5,016,238	6,483,762.0	
601	Sigurime Shoqerore	2,000,000	2,000,000.0	824,497	1,175,503.0	
602	Shpenzime operative	5,000,000	5,000,000.0	2,911,768	2,088,232.0	
603	Subvencione	0	0.0		0.0	
604	Transferta korrente te brendshme (Kap 1)	101,000,000	101,000,000.0	63,856,752	37,143,248.0	
604	Transferta korrente te brendeshme (Kap 6)	700,000	700,000.0	500,000	200,000.0	
605	Transferta korrente te huaja	0	0.0		0.0	
606	Trans per Buxh. Fam Ind	0	0.0		0.0	
	<b>Nen Totali Shpenzime korrente</b>	0	0.0		0.0	
230	Kap te Patrupezuara	0	0.0		0.0	
231	Kapitale te Trupezuara	1,000,000	1,000,000.0	25,500	974,500.0	
232	Transferta Kapitale	0	0.0		0.0	
	<b>Nen Totali Shpenzime kapitale</b>	0	0.0		0.0	
		0	0.0		0.0	
<b>Totali Korrente + Kapitale</b>		<b>121,200,000</b>	<b>121,200,000.0</b>	<b>73,134,755</b>	<b>48,065,245.0</b>	
Jashte Buxhetore		0	0	0	0	
<b>TOTALI (Korrente + kapitale + jashte buxhetore)</b>		<b>0</b>	<b>121,200,000.0</b>	<b>73,134,755.0</b>	<b>48,065,245.0</b>	

Drejtuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Leonida Hasa	Sekretari i Përgjithshëm/Titullari i Institucionit	Emri	Andi Kananaj
	Firma			Firma	
	Data			Data	